



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:253548

Datë: 16.08.2022

Numri i dokumentit: 03329563

C.nr.2411/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Shyqri Hoxha, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Shqipron Sedolli, në çështjen juridike kontestimore sipas padisë së paditëses S.Z., nga Prizreni të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokate E.Gj., nga Prizreni, ndaj të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria e Arsimit të cilën e përfaqëson avokati B.M., me autorizim, me objekt kontesti anulim i konkursit, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor në seancë publike të mbajtur me datë 01.07.2022, dhe i hartuar me shkrim me datën 25.07.2022 mori këtë:

AKTGJYKIM

REFUZOHET në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditëses S.Z., nga Prizreni me të cilën ka kërkuar *“Anulohet konkursi me nr. RNOOOO7189 i datës 25.06.2021 i shpallur nga zyra e personelit në kuadër të DKA në Prizren vetëm sa i përket pozitës për mësimdhënës klasor në afat të pacaktuar në SHFMU “”, Dardani- Prizren të kandidatës së katërt nga lista e kandidatëve të suksesshëm dhe të detyrohet zyra e personelit në kuadër të DKA në Prizren në pozitën e katërt (4) për mësimdhënës në SHFMU ‘.....’”, Dardani- Prizren në pozitën e mësimdhënësit klasor në kohë të pacaktuar ta hap përsëri dhe të veproj sipas ligjit dhe atë në afat prej 15 ditë nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm si dhe të paguaj shpenzimet e procedurës”*

Secila palë i bartë shpenzimet e veta.

Arsyetim

Paditësja, pranë kësaj Gjykate me datën 11.11.2021 ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria e Arsimit me objekt të kontestit anulim i konkursit duke kërkuar që sipas kërkespadiisë të përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në padi, paditësja ka theksuar faktin se ka aplikuar në konkursin e shpallur me datën 25.06.2021 me numër 0000718921 nga Zyra Personelit e të paditurës për pozitën mësimdhënës klasor në kohë të caktuar në SHFMU '.....dhe për pozitën mësimdhënës klasor në kohë të pacaktuar në SHFMU '.....në Arbanë, ku i është nënshtruar të gjitha procedurave. Sipas këtij konkursi në fund të procedurës paditësja është pranuar në pozitën e punës mësimdhënëse në kohë të caktuar në SHFMU '....., lagjen Dardania në Prizren ndërsa në pozitën mësimdhënës në kohë të pacaktuar janë pranuar tre kandidatë të tjerë. Si provë për këtë fakt ka ofruar vendimin e DKA të datës 06.10.2021.

E autorizuar e paditëses av. E.Gj., edhe gjatë shqyrtimit kryesor ka qëndruar pranë padisë dhe në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim ka theksuar se nuk është kontestuese e paditësja ka aplikuar për mësimdhënëse në konkursin e shpallur nga e paditura për mësimdhënës klasor në afat të caktuar dhe të pacaktuar dhe i është nënshtruar të gjitha procedurave të rekurstit dhe se në pozitën mësimdhënës në afat të caktuar ka qenë e poentuar e para ndërsa në pozitën mësimdhënës në afat të pacaktuar ka qenë e poentuar e katërta në listë. Me tutje ka theksuar se në listën e mësimdhënës të pranuar në afat të pacaktuar kanë qenë tri pozita ndërsa pozita e katërt nuk ka qenë dhe se paditësja nuk është njoftuar nga e paditura se është edhe kjo pozitë mirëpo të njëjtën pozitë e ka marrë kandidtja e katërt e cila në listën e mësimdhënës me afat të caktuar ka qenë e renditur e 12 prandaj paditësja ka bërë ankesë mirëpo ende pa përfunduar afati për ankesë e njëjta ka filluar punën dhe se e paditura ankesën e paditëses e ka hedh posht si të paafashtme përkundër që e njëjta ishte e afatshme sepse vendimin e DKA nr.2741 të datës 06.10.2021 e ka pranuar ndërsa ankesën e ka dorëzuar me datën 19.10.2021. Në fund ka theksuar se paditëses i është bërë diskriminim në kuptim të nenit 5 të Ligjit të Punës dhe nenin 24 të Kushtetutës së Kosovës.

I autorizuari i të paditurës av. B.M., në përgjigjen në padi e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit duke theksuar se paditësja nuk ka ofruar asnjë provë se për çfarë shkelje bëhet fjalë përveç asaj që ajo është e punësuar si mësimdhënëse me kohë të caktuar në SHFMU '....."në Prizren. Paditësja me datën 06.10.2021 ka pranuar që të sistemohet si mësimdhënëse në këtë shkollë për çka e ka ofruar deklaratën e datës 06.10.2021 dhe vendimi me numër 2741. Këto fakte e paditura i ka përmendur edhe në fjalën përfundimtare.

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike gjykata sipas propozimit të palëve ndërgjyqëse në shqyrtim kryesor ka administruar këto prova, leximi i listës së kandidatëve të suksesshëm të përzgjedhur sipas konkursit, leximi i vendimit me Nr. 2741 të datës 06.10.2021 të nxjerr nga Komuna e Prizrenit-Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, leximi i ankesës së datës 18.10.2021 të paraqitur nga ana e paditëses, leximi i

vendimit me nr 02-111-163389/1 i dates 26.10.2021 i nxjerr nga komisioni i ankesave në Komunen e Prizrenit dhe leximi i deklaratës se paditëses S.Z., të dhënë pranë DKA-së.

Gjykata pasi që i ka vlerësuar secilën provë veç e veç dhe të gjitha së bashku në kuptim të nenit 8 të LPK-së gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

Gjykata në këtë çështje kontestimore gjeti se nuk është kontestuese fakti se paditësja ka qenë kandidate për pozitën mësimdhënëse në kohë të caktuar dhe të pacaktuar sipas konkursit RN00007189 i datës 25.06.2021, se paditësja pas përfundimit të procedurës së rekrutimit është pranuar në pozitën mësimdhënëse klasore në afat të caktuar në SHFMU '.....' në Prizren sipas vendimit të DKA nr.2741 të datës 06.10.2021 dhe deklartës të dhënë në DKA për pranimin e vendit të punës.

Në mes të palëve ndërgjyqëse kontestues është fakti se a ka qenë e afatshëm ankesa kundër njoftimit të paditurës për pranimin në punë të mësimdhënësve klasor me afat të caktuar dhe të pacaktuar dhe se a ka pas diskriminim gjatë zhvillimit të procedurës së rekrutimit kundër paditëses.

Nga provat e administruara është provuar fakti se paditësja është pranuar pozitën mësimdhënëse në kohë të caktuar dhe të pacaktuar sipas konkursit RN00007189 i datës 25.06.2021 sipas listës të kandidatëve të sukseshëm. Poashtu u provua se paditësja ka filluar nga data 06.10.2021 që të punoj si mësimdhënëse klasore në kohë të caktuar në SHFMU '.....' në Prizren sipas vendimit Nr. 2741 te datës 06.10.2021. Poashtu edhe me deklaratën e dhënë nga paditësja në DKA pranë të paditurës me datën 01.10.2021 vërtetohet fakti se paditësja S.S., e ka pranuar vendin e punës si mësimdhënëse klasore me kohë të caktuar në SHFMU '.....' në Prizren. Deklarata e përmban edhe nënshkrimin e paditëses.

Në bazë të ankesës të parashtruar nga paditësja kundër konkursit RN 00007189 të datës 25.06.2021 në lidhje me pozitën e mësimdhënësit klasor në afat të pacaktuar për 3 pozita në SHFMU '.....' në Prizren, ankesa e mban datën 18.10.2021 dhe nënshkrimin e paditëses por ankesa nuk e përmban vulën e protokolimit pranë të paditurës. Megjithatë me vendimin me nr 02-111-163389/1 i dates 26.10.2021 i nxjerr nga komisioni i ankesave në Komunen e Prizrenit e ka hedh posht ankesën në fjalë si të pasafatshme të parashtrueses S.Z., lidhur me konkursin RN 00007189 i datës 25.06.2021 dhe ka mbetur në fuqi vendimi i komisionit përzgjedhës.

Në këtë çështje kontestimore gjykata i referohet nenin 7.1 të LPK-së ku përcaktohet se *" Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla."* Edhe në nenin 319.1 të LPK-së

rezulton kërkesa që *“Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta.”* Poashtu edhe me nenin 322.2 të LPK-së është përcaktuar se *“Pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër.”*

Gjykata pas analizimit të kërkespadiisë së paditëses gjeti se e njëjta është e pa bazuar sepse faktet të cilat i ka parashtruar paditësja në padi nuk ka ofruar prova të mjaftueshme me të cilat do të provoheshin këto fakte, është fjala për faktin se ankesa e paditëses a ka qenë e paafatshme gjë që është vlerësuar nga komisioni i themeluar në kuadër të paditëses me rastin e hedhjes poshtë të ankesës mirëpo në këtë rast paditësja nuk ka ofruar prova të mjaftueshme për të vëretuar edhe faktin kur e ka parashtruar ankesën e protokoluuar pranë të paditurës dhe në cilën formë të dërgimit e ka dorëzuar ankesën në menyrë që të vlerësohet drejtë ligjshmëria e vendimit të komisionit të ankesave. Në anën tjetër paditësja sipas konkursit anulimin e të cilit e ka kërkuar, veçse ka filluar të punoj nga data 01.10.2021 gjë që është vëretuar nga deklarata e dhënë nga vetë paditësja si dhe vendimi i të paditurës i datës 06.10.2021. Gjykata në këtë rast vlerëson se barra e të provuarit i përket palëve dhe në këtë rast paditësja nuk ka ofruar ndonjë provë me anën e së cilës do të bazohej anulimi i konkursit qoftë edhe mbi bazën e ndonjë forme të diskriminimit, andaj edhe kërkesëpadiia e paditëses është e pabazuar.

Vendimi për shpenzimet e procedurës gjykata e mori në kuptim të nenit 452 par.4 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.2411/2021 datë 25.07.2022

B. Profesional
Shqipron Sedolli

Gjyqtari
Shyqri Hoxha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e pranimit të kopjes së aktgjykimit, Gjykatës së Apelit e Kosovës, përmes kësaj Gjykate.